



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /Ministry of Internal Affairs

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar / Departament za Reintegraciju Repatriranilh
Lica / Department for Reintegratin of Repatriated Persons

**Udhëzues për Ripranimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve të
Pashoqëruar**



Tabela e përmbajtjes.....	2
Kapitulli I - Dispozitat e përgjithshme	3
1. Qëllimi.....	3
2. Fushëveprimi	3
3. Përkufizimet dhe shkurtesat.....	3
4. Parimet	6
Kapitulli II – Intervistimi i Fëmijëve të Pashoqëruar	8
Kapitulli III – Ripranimi dhe Riintegrimi.....	10
3.1. Masat para ripranimit	10
3.2. Pranimi në aeroport dhe pikat tjera të kalimit kufitar	12
3.2. Asistenca në momentin e arritjes.....	13
Kapitulli IV – Arritja në Komunë-Akomodimi dhe Vlerësimi i nevojave.....	14
4.1. Akomodimi në familje.....	14
4.2. Procesi për vlerësimin e nevojave.....	14
Kapitulli V – Ofrimi i shërbimeve emergjente për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar.....	14
Kapitulli VI – Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për riintegrim të qëndrueshëm për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar.....	16
6.1. Banimi	16
6.2. Arsimi.....	17
6.2.1. Sigurimi i qasjes në shkollë për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar	18
6.2.2. Ofrimi i arsimit cilësor.....	18
6.3. Shëndeti.....	19
6.3.1. Shëndeti mendor.....	20
6.4. Regjistrimi civil.....	20
6.5. Mirëqenia sociale.....	20
6.5.1. Asistenca sociale dhe qasja në beneficione	20
Kapitulli VII – Mbrojtja e Fëmijëve të Pashoqëruar	21
Kapitulli VIII – Sistemi i Menaxhimit të Rasteve.....	22
Kapitulli IX. Koordinimi ndërmjet akterëve në nivelin qendror dhe lokal.....	23
9.1. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin qendror	23
9.2. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin lokal	23
9.3. Koordinimi vertikal	24
Kapitulli X – Menaxhimi i Buxhetit të Riintegrit.....	25
Kapitulli XI - Monitorimi dhe llogaridhënia	25
11.1. Monitorimi i progresit	25
11.2. Llogaridhënia.....	26
11.2.1. Mjetet juridike për realizimin e të drejtave për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar.....	26
Kapitulli XII – Promovimi dhe ngritja e kapaciteteve	26

Kapitulli I. Dispozitat e përgjithshme

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzuesi është shumë dimenzional dhe përfshinë një numër shumë të madh të veprimeve që institucionet, komuniteti dhe familjet duhet ndërmarrë për të siguruar një mbrojtje urgjente për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, në mënyrë që të sigurohet dhe garantohet riintegrimi i qëndrueshëm i tyre.

Përmjes këtij udhëzuesi po ashtu synohet që të:

1. Definohen dhe përcaktohen fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar;
2. Definohen rolet dhe përgjegjësitë e akterëve të involvuar;
3. Lehtësohet implementimi i legjislacionit pozitiv në Kosovë, akteve dhe standardeve tjera ndërkombëtare;
4. Fuqizohet bashkëpunimi dhe koordinimi i procedurave të institucioneve relevante për ofrimin e mbrojtjes adekuate dhe procesin e riatdhesimit dhe riintegrit të fëmijëve të pashoqëruar;
5. Sigurohet që fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar të jenë në gjendje të qasen dhe të gëzojnë të drejtat e tyre;
6. Ofrohen udhëzime për mbrojtjen, përkujdesjen dhe trajtimin e duhur të fëmijëve të pashoqëruar, bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, me referencë të posaçme në parimet e mos-diskriminimit, interesit më të mirë të fëmijëve dhe të drejtën e fëmijës për të shprehur lirshëm pikëvështrimet e tij apo saj.

2. Fushëveprimi

Ky udhëzues zbatohet nga të gjitha institucionet e përfshira në të gjitha rastet e fëmijëve të pashoqëruar që i nënshtrohen procedurave të riatdhesimit dhe riintegrit në Kosovë.

Ky proces përfshinë si masat para ripranimit, ndihmën e menjëhershme pas arritjes, ashtu edhe ndihmën dhe mbështetjen për riintegrim të qëndrueshëm dhe përfshirjen në shoqëri.

3. Përkufizimet dhe shkurtesat

“Fëmijë të pashoqëruar” janë fëmijët, siç është përkufizuar në nenin 1 të Konventës, të cilët janë ndarë nga të dy prindërit dhe të afërmit e tjerë dhe janë pa përkujdesje nga një i rritur i cili, sipas ligjit, është përgjegjës për të bërë këtë gjë.

“Fëmijë” siç është përkufizuar në nenin 1 të Konventës, nënkupton “çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet”. Kjo do të thotë që çfarëdo instrumenti që aplikohet për fëmijët në territor të shtetit nuk mund të përkufizojë fëmijën në ndonjë mënyrë që devijon nga normat që përcaktojnë moshën madhore në atë shtet.

“Fëmija pa përkujdesje prindërore” nënkupton fëmijën, prindërit e të cilit nuk mund të gjenden, është në burg, ose është i privuar në ndonjë formë nga liria, ka vdekur, janë shpallur të zhdukur dhe fëmija që jeton pa kujdes të vazhdueshëm të prindërve ose kujdestarit të tij, fëmijët që janë zhvendosur nga familja dhe mjedisi i familjes, fëmija që ka lënë familja me zgjedhjen e tyre, ose fëmija migrantë i pashoqëruar”.

“Përfaqësues ligjor” nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësiqë i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;

“Menaxheri i rastit”, nënkupton zyrtarin përgjegjës i caktuar nga organi i kujdestarisë, për menaxhimin e rastit të fëmijës, i cili në bashkëpunim me akterët relevantë vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes;

“Ripranimi” është akt i shtetit për pranimin e rihyrjes së shtetasit të tij i cili ka hyrë, apo është i pranishëm në mënyrë të paligjshme në një shtet.

“Vendi i origjinës” është vendi i shtetësisë apo, në rast të fëmijës pa shtetësi, vendi i banimit të përhershëm.

“Person i riatdhesuar” nënkupton një kosovar i cili në mungesë të bazës ligjore për qëndrim në vend të huaj është ripranuar në Kosovë.

“Riintegrimi” nënkupton ripërfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës dhe promovimin e kushteve të tyre ekonomike, sociale dhe politike.

“Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës” nënkupton çdo shërbim për ofrimin e përkujdesjes sociale, këshillimit psikosocial, asistencës ligjore, përfaqësimit ligjor, shërbimit shëndetësor, edukativ, arsimor, kulturor ose, në raste të veçanta, ndihmë materiale për fëmijën në nevojë;

“Organi i kujdestarisë” nënkupton organin komunal profesional kompetent dhe përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijës, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale;

“Drejtësia mike ndaj fëmijës” nënkupton sistemin e drejtësisë që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, duke marrë parasysh parimet e njohura për mbrojtjen e fëmijës dhe duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit të fëmijës, dhe rrethanave të rastit.

“Përfitimet” nënkuptojnë masat për mbështetjen nga programi i riintegrit.

“Ndihma dhe mbështetja” nënkupton shërbimet për mbështetjen e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar gjatë procesit të ripranimit dhe riintegrit.

“Sistemi për menaxhimin e rasteve” (SMR) është sistem elektronik ku procedohen, ruhen dhe arkivohen informatat për personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre.

“Koordinimi” nënkupton që ministritë përkatëse, autoritetet dhe akterët e tjerë e mbështesin riintegrimin në mënyrë efektive bashkë si tërësi.

“Mbrojtja” i referohet të gjitha aktivitetëve që synojnë sigurimin e respektit të plotë për të drejtat e individit, në këtë rast të fëmijut, sikur që është përcaktuar në instrumentet relevante të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Janë tri lloje esenciale dhe gjithëpërfshirëse të veprimit për të ndihmuar fëmijët e pashoqëruar.

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
ARC	Agjencioni i Regjistrimit Civil
EPRBM	Ekipi për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mos-regjistrimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DRPR	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
LEB	Lista Esenciale e Barnave
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKK	Pikat e Kalimit Kufitar
PK	Policia e Kosovës
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHM	Qendra për Shëndet Mendor
QPMS	Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale
QPS	Qendra për Punë Sociale
RKS	Republika e Kosovës
SMR	Sistemi i Menaxhimit të Rasteve
ZP	Zyrtari Pritës
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKP	Zyra Komunale për Punësim
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

4. Parimet

Udhëzuesi bazohet nga parimet gjithëpërfshirëse, që dalin nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, në veçanti të drejtat e fëmijëve, standardet dhe parimet e qeverisjes së mirë, si dhe legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Parimet kryesore për të drejtat e fëmijëve, përfshijnë:

(1) Pandashmërinë dhe ndërvlerësinë.

Zbatimi i udhëzuesit duhet të ketë qasje ndërsektoriale dhe të integruar në të gjitha fushat që prekin jetën e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, duke kërkuar koordinim të shtuar ndërmjet të gjithë akterëve të përfshirë në proces.

(2) Mos-diskriminimin dhe vëmendjen e veçantë për nevojat e fëmijëve të cënueshëm.

Përmes këtij udhëzuesi i kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar të cënueshëm, integrimi i të cilëve kërkon masa të veçanta. Parimi i mos-diskriminimit, në të gjitha aspektet e tij, aplikohet në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët të pashoqëruar. Në veçanti, ai ndalon çfarëdo diskriminimi në baza të statusit të fëmijës si i pashoqëruar. Ky parim, kur kuptohet si duhet, nuk parandalon, por në fakt mund të kërkojë, diferencim në bazë të nevojave të ndryshme për mbrojtje siç janë ato që dalin nga mosha dhe/apo gjinia. Gjithashtu masat duhet ndërmarrë edhe për adresimin e perceptimeve të gabuara të mundshme apo stigmatizimit të fëmijëve të pashoqëruar brenda shoqërisë. Mbajtja nën kontroll apo masat tjera që kanë të bëjnë me fëmijët e pashoqëruar që lidhen me rendin publik janë të lejueshme vetëm atëherë kur masat e tilla bazohen në ligj, kërkojnë vlerësim individual më tepër sesa kolektiv, janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, dhe paraqesin opsionin më së paku të bezdisshëm.

(3) Interesi më i mirë për fëmijët.

Interesi më i mirë për fëmijët është fokusi kryesor në të gjitha aspektet e procesit të riatdhesimit dhe riintegrit. Gjatë vendimarrjes, autoritetet publike dhe private dhe akterët tjerë relevant duhet të marrin në konsideratë efektet e mundshme të atij vendimi në jetët e fëmijëve.

Neni 3¹ paragrafi (1) përcakton që “ në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike apo private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”. Në rast të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, parimi duhet të respektohet gjatë të gjitha fazave të ciklit të riatdhesimit. Në cilëndo nga këto faza, përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të dokumentohet në përpilim të çfarëdo vendimi që thellësisht ndikon në jetën e fëmijës së pashoqëruar apo të ndarë.

Përcaktimi se çka është në interes më të mirë të fëmijës kërkon vlerësim të qartë dhe gjithëpërfshirës të identitetit të fëmijës, duke përfshirë shtetësinë e saj apo tij, arsimin, prejardhjen etnike, kulturore dhe gjuhësore, cënueshmëritë e veçanta apo nevojat për mbrojtje. Procesi i vlerësimit duhet të realizohet në atmosferë miqësore dhe të sigurt nga profesionistë të kualifikuar që janë të trajnuar për teknika intervistim të ndjeshëm ndaj moshës dhe gjinisë.

Zbatimi urgjent i hapave pasues, të përcaktuar në këtë udhëzues dhe Rregulloren 04/2016, shërbejnë si mbrojtje kyçe procedurale për të siguruar respektim të interesit më të mirë të fëmijës së pashoqëruar.

¹ Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Respektimi i interesit më të lartë gjithashtu kërkon që, atëherë kur autoritetet kompetente kanë vendosur fëmijën e pashoqëruar “për të qenë nën kujdesje, mbrojtje, ose trajtim të shëndetit të tij apo saj fizik ose mendor”, institucionet duhet t’i garantojnë të drejtën e atij fëmije për “ekzaminim periodik” të trajtimit të tyre dhe “çdo rrethanë tjetër lidhur me vendosjen e tij apo saj”².

*(4) E drejta për jetesë, mbijetesë dhe zhvillim.*³

Udhëzuesi ka për qëllim të siguroj mundësitë maksimale për zhvillim fizik, mendor, shpirtëror dhe psikologjik për fëmijët e riatdhesuar të pashoqëruar, në veçanti të atyre me rrezikshmëri të lartë të marginalizimit. Për më tepër sipas nenit 6 të KDF institucionet janë të detyruara të ofrojnë mbrojtjen nga dhuna dhe shfrytëzimi, deri në shkallën më të lartë të mundshme, që do të rrezikonte të drejtën e fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim. Fëmijët e pashoqëruar janë të cenueshëm ndaj rreziqeve të ndryshme që prekin jetën e tyre, mbijetesën dhe zhvillimin siç është trafikimi për qëllime të shfrytëzimit seksual apo shfrytëzimit tjetër apo përfshirje në aktivitete kriminale që do të rezultojnë në dëmtim të fëmijës, apo në raste ekstreme, në vdekje. Prandaj, neni 6 e bën të domosdoshëm vigjilencën e institucioneve në këtë aspekt, posaçërisht kur mund të jetë përfshirë krimi i organizuar.

*(5) E drejta e fëmijës për të shprehur lirshëm pikëpamjet e veta.*⁴

Vendimet individuale dhe kolektive, ofrimi i shërbimeve e llogaridhënia dhe mekanizmat tjerë që ndikojnë në fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duhet të marrin në konsideratë edhe pikëpamjet e tyre. Në pajtim me nenin 12 të Konventës, në përcaktimin e masave që do të miratohen përkitazi me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duhet të nxirren pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës dhe të merren në konsideratë (nen. 12 (1)). Për të mundësuar të shprehur të bazuar në mirë-informim të pikëpamjeve dhe dëshirave të tilla, është thelbësore që fëmijëve të tillë t’u ofrohen të gjitha informatat relevante që kanë të bëjnë, për shembull, me të drejtat e tyre, shërbimet në dispozicion duke përfshirë mjetet e komunikimit, gjurmimin familjar dhe gjendjen në vendin e tyre të origjinës (nen. 13, 17 dhe 22 (2)). Pikëpamjet e fëmijëve duhet të merren në konsideratë edhe në aranzhimet e kujdestarisë, përkujdesjes dhe akomodimit, si dhe në përfaqësim ligjor. Informatat e tilla duhet të ofrohen në një mënyrë që është e përshtatshme me pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit të secilit fëmijë. Meqenëse pjesëmarrja varet nga komunikimi i besueshëm, atëherë kur është e nevojshme, përkthyesit duhet të vihen në dispozicion në të gjitha fazat e procedurës.

(6) Konfidencialiteti.

Institucionet dhe akterët që zbatojnë këtë udhëzues duhet të mbrojnë konfidencialitetin e informatave të pranuar në lidhje me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, në përputhje me detyrimin për të mbrojtur të drejtat e fëmijës, duke përfshirë të drejtën për privatësi (nen. 16 i KDF). Ky detyrim aplikohet në të gjitha suazat, duke përfshirë shëndetësinë dhe mirëqenien sociale. Duhet kushtuar kujdes që informatat e kërkuara dhe të shkëmbyera në mënyrë legjitime për një qëllim të mos përdoren në mënyrë të papërshtatshme për një qëllim tjetër. Shqetësimet lidhur me konfidencialitetin gjithashtu përfshijnë respektimin e të drejtave të të tjerëve. Për shembull, në marrjen, ndarjen dhe ruajtjen e informatave të mbledhura në lidhje me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duhet kushtuar kujdes i veçantë në mënyrë që të mos rrezikohet mirëqenia e personave që janë ende në vendin e origjinës së fëmijës, veçanërisht anëtarët e familjes së fëmijës. Për më tepër, informatat lidhur me vendndodhjen e fëmijës duhet të mbahen

² Neni 25 i KDF

³ Neni 6 i KDF

⁴ Neni 12 i KDF

vetëm me prindërit, familjarët e afërm apo familjet strehuese atëherë kur është e nevojshme për sigurinë e fëmijës apo për të siguruar “interesin më të mirë” të fëmijës.

Udhëzuesi promovon parimet e qeverisjes së mirë duke përfshirë:

- (1) *Unitetin apo integritetin e familjes.* Të gjithë fëmijët kanë të drejtën për të jetuar dhe për të qenë së bashku me familjen, dhe anasjelltas familjet kanë të drejtën dhe obligimin që të përkujdesen dhe të jetojnë në bashkësi me fëmijët. Fëmijëve të pashoqëruar duhet ofruar mundësi dhe shërbime që kanë për qëllim bashkimin me prindërit apo kujdestarët ligjor sa më shpejtë që të jetë e mundur. Nëse kemi shumë fëmijë të pashoqëruar apo ndarë, prioritet duhet t'i jipet atyre që janë më të cënueshëm, duke marrë për bazë rethanat dhe kushtet në të cilat ata janë. Në rastet kur bashkimi me prindërit apo me ndonjërin prej familjarëve të linjës së gjakut nuk është i mundur, konsideratë dhe përparësi duhet t'i jipet dërgimi dhe bashkimi me familjarë të afërm apo familjeve strehuese, krejt kjo për të shmangur dërgimin e fëmiut në institucion të përkujdesjes.
- (2) *Respektimin e sundimit të ligjit.* Udhëzuesi mbështet respektimin e legjislacionit ekzistues nga të gjithë akterët, forcon zbatimin dhe fuqizon legjislacionin ekzistues dhe synon të sigurojë mjete juridike efektive në rast të moszbatimit.
- (3) *Qëndrueshmëria.* Udhëzuesi ka për qëllim të sigurojë riintegrim të qëndrueshëm të fëmijët e pashoqëruar të riadhesuar, duke siguruar zhvendosje nga ndihma emergjente në zgjidhje të qëndrueshme.
- (4) *Transparenca.* Udhëzuesi ndihmon në sigurinë fëmijët e pashoqëruar të riadhesuar janë plotësisht të vetëdijshëm lidhur me të drejtat e tyre dhe kuptojnë proceset për të kërkuar ato. Udhëzuesi promovon standarde të transparencës në alokim të resurseve dhe shpenzimeve.
- (5) *Llogaridhënia.* Udhëzuesi promovon mekanizmin e llogaridhënies për të siguruar që bartësit e detyrave përmbushim rolin e tyre në mënyrë efektive, në harmoni me të drejtat e njeriut dhe parimet e qeverisjes së mirë.
- (6) *Subsidiariteti.* Udhëzuesi i referohet nivelit lokal në pajtim me kompetencat e specifikuar në Rregulloren 04/2016, me përkrahje nga niveli qendror, sipas nevojës. Po ashtu i referohet Direktivës 2008/115/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, që thotë se (neni 10) “para largimit të fëmijës së pashoqëruar nga territori i Shtetit Anëtar, autoritetet e atij Shteti Anëtar duhet të jenë të kënaqur që ai apo ajo do të kthehet tek anëtar i familjes së tij apo saj, tek kujdestari i caktuar apo hapësirat adekuate të pranimit në shtetin e kthimit”.

Kapitulli II. Intervistimi i Fëmijëve të Pashoqëruar

1. Qasja dhe ambienti miqësor gjatë intervistimit

Qasja dhe mjedisi ku zhvillohet intervista mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në sasinë dhe cilësinë e informacionit të përfituar. Sipas hulumtimeve stresi e vështirëson kujtesën, rrjedhimisht dhe shoqërohet me konfuzion të shtuar. Sigurimi i mundësisë për fëmijën për t'u intervistuar në një mjedis të sigurt dhe ku fëmija është në qendër të vëmendjes, e minimizon mundësinë e traumës së mëtejshme, e maksimalizon cilësinë dhe sasinë e informacionit të ndarë dhe zvogëlon ndikimet sugjestive, duke përmirësuar kështu saktësinë e informacionit të dhënë dhe duke e ruajtur në të njëjtën kohë integritetin e intervistës. Andaj, zhvillimi i intervistës me një qasje dhe në një dhomë miqësore ndaj fëmijës siguron kushtet e privatësisë dhe plotëson nevojat e fëmijëve, duke i bërë ata, që gjatë procesit të intervistimit, të ndjehen të sigurt në aspektin psikologjik dhe fizik.

2. Elementet kryesore të zhvillimit të intervistës miqësore

Qëllimi i përgjithshëm gjatë zhvillimit të intervistës është të krijohet raporti dhe të merret informacioni që ka të bëjë me aftësitë zhvillimore dhe të komunikimit të fëmijës. Intervistuesi duhet të bëjë prezantime, të krijoj role, të japë udhëzime, t'i shpjegojë pritjet nga intervista, ta vlerësojë zhvillimin e fëmijës, të krijojë situata për nxitjen e reagimeve narrative, dhe të krijojë një atmosferë relaksuese dhe miqësore.

3. Prezantimet dhe udhëzimet e intervistuesit

- Orientoje fëmijën në një ambient miqësor që nuk cenon dinjitetin e tij/saj;
- Bëni prezantimet/njoftimet, duke përfshirë emrat dhe rolet;
- Jepi fëmijës një sens kontrolli, duke i dhënë atij zgjedhje kurdo që është e mundshme;
- Jepini atij leje për të bërë pyetje në lidhje me procesin e riatdhesimit dhe riintegritimit, dhe arsyet pse zhvillohet kjo intervistë;

Hulumtimet tregojnë se përforcimi i opsioneve të përgjigjeve e ulë sugjestibilitetin e fëmijës dhe e rritë rezistencën ndaj pyetjeve keqdrejtuese.

Opsionet standarde të përgjigjeve/udhëzimeve mund të përfshijnë:

- "Më korrigjo, nëse jam duke kuptuar diçka gabim."
- "Më lejo të di nëse nuk i ke kuptuar pyetjet e mia."
- "Nëse nuk dëshiron të përgjigjesh në ndonjë pyetje, është në rregull të thuash, 'Nuk e di'."
- "Nëse nuk e din, atëherë kjo është në rregull për të thënë," Unë nuk e di. "
- "Mos u përpiq t'ia qëllosh."
- "Mund të shkosh ose të bësh pauzë kurdo që ndjen se ke nevojë."

Për fëmijët më të vegjël, shqyrtoni mundësinë e kerkimit nga ta që ta demonstrojnë aftësinë e tyre për të ndjekur udhëzime. Kur fëmija të jetë në gjendje ta korrigjojë me sukses intervistuesin, përforcimi pozitiv mund të aplikohet për ta nxjerrë në pah aftësinë e tij të demonstrimit të shkathhtësisë. Fëmijët më të vegjël mund të funksionojnë më mirë me një numër të kufizuar rregullash dhe me ushtrime. Fëmijët më të rritur mund të jetë në gjendje të përballojnë më shumë dhe mund të mos kenë nevojë për të ushtruar.

4. Prezantimi i temës me interes

Kalimi në "temën me interes" ose "pjesa e fokusuar-në supozim" të intervistës duhet të realizohet në mënyrën më të hapur të mundshme dhe sa ma pak sugjестive. Kjo mund të arrihet në shumë mënyra:

- Zbulimi spontan i informacionit mund të ndodhë gjatë fazave të hershme të intervistës, duke lejuar një kalim të natyrshëm në temën me interes. Për shembull, gjatë praktikës narrative, fëmija përshkruan si ka ndodhur procesi i kthimit nga shteti dërgues, apo eventualisht specifikon ndonjë element të shkeljes së ndonjë të drejte, ose në rastet më të rënda për ndonjë abuzim/keqtrajtim të mundshëm.
- Nëse vlerësohet se është krijuar besimi i ndërsjellë dhe nuk ka ndonjë indikacion për ndonjë informatë tjetër të rëndësishme për fëmijën e që do të ndikonte me pastaj në procesin e riintegrit, mund të vazhdohet në pjesën e informatave të përgjithshme.
- Radha e pyetjeve të mësipërme duhet të jetë një udhëzues dhe jo diçka absolute: nderojë procesin dhe veçantinë e çdo fëmije dhe interviste.

5. Përfundimi i intervistës

Intervista me një fëmijë mund të përmbyllet atëherë kur intervistuesi ka marrë informacion të mjaftueshëm dhe/ose kur fëmija nuk shpreh interesim ose nuk është në gjendje të marrë pjesë më tutje në intervistë. Nëse fëmija nuk shpreh dëshirë ose nuk është në gjendje të marrë pjesë në intervistë, intervistuesi do të duhej të përpiquej ta përcaktojë arsyen dhe në mënyrë të duhur të reagojë ndaj saj. Interesat më të mira të fëmijës duhet të ngelen gjithnjë prioritet i intervistuesit. Fëmijës nuk duhet t'i ushtrohet presion për të qëndruar në ambientin e intervistimit, presioni i tillë mund të rezultojë në marrjen e pohimeve të pasakta dhe mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e fëmijës. Në rastet kur informacioni relevant nuk është marrë nga fëmija, intervistuesi mund të ketë nevojë t'i shqyrtojë mundësitë tjera siç janë referimi për psikoterapi ose intervista shtesë.

6. Komponentet përmbyllëse të një interviste

Ofroni fëmijës mundësinë për të bërë pyetje. Përgjigjuni pyetjeve me sinqeritet, duke ofruar informacion. Mos jepni premtime ose garanci për atë se çfarë mund ose nuk mund të ndodhë pas intervistës. Lejoni që fëmija të diskutojë për temat/çështjet/shqetësimet që ai/ajo mendon se janë të rëndësishme, duke përfshirë temat që nuk janë trajtuar më parë. Kjo i jep fëmijës mundësi për ta komunikuar informacionin që ai/ajo e gjykon të rëndësishëm, e që mund të jetë diçka që pyetjet e intervistës nuk e kanë adresuar akoma ose informacioni që ai/ajo nuk e ka ndërlidhur me pyetjet që i janë bërë deri atëherë. Provoni të bëni fëmijës pyetjet si, "A ka ndonjë pyetje që kam harruar të të pyes sot?" dhe "A ka ndonjë gjë tjetër që mendon se është me rëndësi ta di unë sot?"

7. Stafi përgjegjës për intervistimin e fëmijëve të pashoqëruar

Stafi përgjegjës për intervistimin e fëmijëve të pashoqëruar do të trajnohet në vazhdimësi për zhvillimin e intervistave me qasje miqësore ndaj fëmijëve me qëllim të sigurimit të kapaciteteve adekuate profesionale.

Kapitulli III. Ripranimi dhe Riintegrimi

3.1. Masat para ripranimit

Akterët kryesorë: MPB- Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM), Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar (DRPR), Policia e Kosovës/ILECU.

Veprimi për rastet individuale

Vendi kërkues i dërgon DSHAM-së të dhënat e fëmijës së pashoqëruar i cili është në procedurë të riatdhesimit. DSHAM kërkon nga shtetet përkatëse parashtruese të kërkesave për riatdhesim të fëmijëve të pashoqëruar, që në kërkesat e tyre të përfshijnë sa më shumë të dhëna personale, mundësisht edhe fotografitë e tyre. DSHAM bën verifikimin e fëmijës nëse është shtetas i Kosovës. Në rast të vështirësive të verifikimit të fëmijëve të pashoqëruar, kërkon nga Policia e Kosovës që të bëjë verifikimin e familjes në teren. Kërkesa për verifikim apo njoftim duhet të përcillet në PK mundësisht 3 deri 5 ditë pune, kohë kjo e nevojshme për verifikim nga PK-ja. DSHAM informon DRPR për secilën kërkesë për riatdhesim të fëmijëve të pashoqëruar.

Nëse konstatohet nga ekspertët se janë plotësuar kushtet ligjore për ripranimin e fëmijës, DRPR përmes MPMS kërkon nga Qendra për Punë Sociale të komunës përkatëse vizitën te familja dhe konstatimin e gjendjes familjare. Qendra për Punë Sociale e komunës përkatëse kontakton dhe viziton familjen me qëllim të konstatimit të statusit socio-ekonomik të familjes. QPS përgatitë raport të detajuar për gjendjen e familjes dhe gadishmërinë e pranimit të fëmijës së pashoqëruar. QPS raportet përkatëse dhe dokumentacionin përcjellës i dërgon tek DRPR përmes MPMS. DSHAM, bazuar në raportet e pranuar nga DRPR informon shtetin kërkues mbi gjendjen faktike të familjes së fëmijës së pashoqëruar në procedurë të riatdhesimit. DSHAM kërkon nga homologu i vendit kërkues të siguroj dokumentacionin shoqëruar të fëmijës së pashoqëruar për të cilin/cilën është bërë kërkesa për kthim.

Këto dokumente përfshijnë:

Situata sociale

- ☐ Informatat relevante nga dosja personale e fëmijës e menaxhuar nga shërbimi social apo organizata përgjegjëse që do të shërbejë për mbështetjen e riintegrit të fëmijës së pashoqëruar të riatdhesuar.

Familja/farefisi

- ☐ Informatat lidhur me familjen apo farefisin me të cilin do të jetë në kontakt fëmija i pashoqëruar pas riatdhesimit.
- ☐ Çdo informatë nëse fëmija i pashoqëruar gjatë procesit të riatdhesimit, shoqërohet përkohësisht nga ndonjë person i caktuar nga shteti dërgues.

Regjistrimi

- ☐ Certifikata e lindjes dhe dokumentet tjera të regjistrimit civil për fëmijët e lindur jashtë Kosovës.

Arsimi

- ☐ Certifikata/diploma mbi nivelin e arsimimit apo ndonjë arsimim tjetër alternativ apo arsimimi plotësues i përfunduar.

Shëndeti

- ☐ Informatat lidhur me shëndetin, përfshirë imunizimin, sëmundjet dhe gjendja shëndetësore dhe informatat tjera relevante lidhur me shëndetin.
- ☐ Evidenca për ndonjë paaftësi qoftë mentale apo fizike.

Zbatimi i ligjit

- ☐ Informatat nëse fëmija ka ndonjë kundërvajtje/shkelje të miturve.

DSHAM duhet të bëj kërkesën për dokumentet e lartpërmendura së bashku me aprovimin për ripranim të fëmijës së pashoqëruar. DSHAM dhe DRPR bashkëpunojnë ngusht para, gjatë dhe pas procesit të ripranimit. Nëse informatat lidhur me shëndetin zbulojnë se fëmiju i pashoqëruar në procedurë të riatdhesimit ka gjendje të rëndë shëndetësore për të cilën, sipas konstatimit të MSH-së nuk ka mundësi trajtimi në Kosovë, DSHAM e informon vendin kërkues brenda 24 orëve pas marrjes së kësaj informate. Shteti kthyes informon DSHAM për datën dhe vendin e kthimit të fëmijës së pashoqëruar. DSHAM informon DRPR-në, për kohën dhe vendin e kthimit dhe i dërgon DRPR raportet verifikuese dhe dokumentacionin përcjellës për kthimin e fëmijës së pashoqëruar. DRPR informon MPMS/QPS-në, në rast nevojë MSH-në dhe PK-në, për organizimin e pritjes së fëmijës së pashoqëruar. QPS-ja informon familjen dhe siguron prezencën e prindërve për pritjen e tij/saj në pikën e kalimit kufitarë. Punëtori social do të jetë prezent në pikën e kalimit kufitar në të gjitha rastet e kthimit të fëmijës së pashoqëruar.

Veprimet për praktika të qëndrueshme

DSHAM në koordinim me DRPR përgatitë listën e informatave dhe dokumenteve bazë të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, që vendet dërguese duhet të kenë parasysh me rastin e kthimit. Kjo listë përfshinë, por nuk kufizohet në dokumentet e përcaktuara më lartë. Në marrëveshjet bilaterale për ripranim, MPB do të merr parasysh informatat e nevojshme dhe dokumentacionin përcjellës për fëmijët e pashoqëruar e riatdhesuar. Ministria e Shëndetësisë dhe QKUK përgatisin listën e sëmundjeve që nuk trajtohen në Kosovë. Lista publikohet në ueb faqen e MSH-së dhe i dërgohet MPB-së (DSHAM dhe DRPR). Pas pranimit të njoftimit për kthim të fëmijëve të pashoqëruar që kanë nevojë për asistencë mjekësore, DRPR koordinon pritjen e organizuar me MSH-në, duke siguruar prezencën e mjekëve specialist në PKK. Po ashtu përmes MPMS-në siguron prezencën e prindërve dhe puntorit social si pjesë e ekipit të pritjes. Njoftimi i dërgohet zyrtarit të emëruar si pikë e kontaktit në procesin e riintegrit për ministrinë përkatëse. Po ashtu, gjatë tërë procesit mbahet e informuar edhe Zyra Pritëse në ANP.

3.2. Pranimi në aeroport dhe pikat tjera të kalimit kufitar

Akterët kryesorë: Ministria e Punëve të Brendshme –Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar, Policia e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komuna/Qendra për Punë Sociale.

Me rastin e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar sigurohet prezenca e ekipit përkatës për pritjen dhe ripranimin e tyre. MPB-ja siguron prezencën e zyrtarëve të cilët flasin njërën nga gjuhët zyrtare të RKS-së. Kur vendi dërgues njofton që fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar nuk komunikojnë në njërën nga gjuhët zyrtare të RKS-së, DSHAM dhe DRPR sigurojnë përkthyes për gjuhët përkatëse. Formularët e pranimi do të jenë të disponueshëm në zyrën pritëse të riintegrit me rastin e arritjes së fëmijës së pashoqëruar të riatdhesuar në ANP dhe PKK-të.

3.3. Asistenca në momentin e arritjes

Informimi

Zyrtari i pritjes në aeroport dhe në pikat tjera të kalimit kufitar informojnë fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar për të drejtat e tyre dhe mundësitë e përfitimit, të cilët po ashtu i ofrojnë fëmijëve të pashoqëruar fletëpalosjet informative.

Vlerësimi i nevojave fillestare

Ekipi i pritjes bën vlerësimin e nevojave fillestare në bazë të informatave dhe dokumentacionit në dispozicion dhe intervistës me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar.

Vlerësimi i nevojave fillestare identifikon:

- (1) Nevojën për ndihmë emergjente (sipas nevojës sigurimin falas për trajtim shëndetësor, psikologjik dhe atë të ndihmës juridike falas);
- (2) Sigurimin e ushqimit konform vlerësimit të nevojave të fëmijut;
- (3) Gjendjen socio-ekonomike të familjes;
- (4) Ekzistencën e rrjetit përkrahës, si p.sh. të afërmit në Kosovë;
- (5) Gjuhën e folur fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duke përfshirë zotërimin nga fëmijët të gjuhëve zyrtare në Kosovë për qëllime shkollimi;
- (6) Strukturën familjare dhe cenushmërinë, nevojat e parashikuara të fëmijëve në varësi nga mosha e tyre, gjendja ekonomike, nevojat specifike/aftësitë e kufizuara, niveli shkollor, gjuha, përkatësia etnike, si dhe kritere tjera relevante;
- (7) Detektimin e çështjeve problematike brenda familjes;
- (8) Nevojën emergjente për akomodim dhe strehim të përkohshëm, që do të ofronte mbrojtje në kuptimin e sigurisë fizike dhe emocionale.

Regjistrimi i të dhënave në SMR

Zyrtarët pritës regjistrojnë informatat në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (SMR) brenda njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i fëmijës së pashoqëruar të riatdhesuar. Çështjet që kërkojnë vëmendje të veçantë evidentohen në sistem dhe raportohen drejtpërdrejt në DRPR për veprim të mëtejshëm.

Sigurimi i transportit nga ANP dhe PKK në vendin e destinacionit

Zyrtarët e pritjes, në rast nevojë, organizojnë transportin e fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar në shoqërimin e prindit/kujdestarit ligjor dhe të punëtorit social nga ANP dhe pikat tjera të kalimit kufitar deri në vendin e destinacionit. Në raste kur kërkohet dhe është e nevojshme

Policia e Kosovës, në prani të punonjësit të Qendrës për Punë Sociale, bën përcjelljen e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës dhe Pikat tjera të Kalimit Kufitar deri në vendin e destinacionit kur ka informata se fëmija rrezikohet, për shkak të së kaluarës së tij, i cili mund të ketë qenë subjekt i dhunës në familje, trafikimit apo abuzimit ndaj tij.

Kapitulli IV. Arritja në komunë – Akomodimi dhe vlerësimi i nevojave

Akterët kryesorë: Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) me përkrahje nga Qendra për Punë Sociale (QPS), DRPR/Kordinatorët, në koordinim me drejtoratet tjera komunale (shëndetësi, arsim, mirëqenie sociale dhe drejtorateve tjera).

4.1 Akomodimi në familje

Fëmija i pashoqëruar pas riadhesimit akomodohet në familjen e tij/saj, gje e cila është në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Në rast nevojë, bazuar në vlerësimin nga menaxheri i rastit, fëmijët e pashoqëruar mund të strehohen tek familjet strehuese, në harmoni me legjislacionin përkatës në fuqi.

4.2. Procesi për vlerësimin e nevojave

Me të arritur në komunë, Qendra për Punë Sociale e komunës përkatëse cakton menaxherin e rastit për fëmijën e pashoqëruar të riadhesuar. Brenda 72 orëve pas vendosjes së fëmiut të pashoqëruar të riadhesuar në familje, Qendra për Punë Sociale/Menaxheri i rastit, me përkrahje nga ZKKK-ja dhe Kordinatori i Riintegritimit, bën vlerësimin e nevojave të fëmiut të riadhesuar. Vlerësimi i nevojave kryhet përmes shqyrtimit të informatave në sistemin e menaxhimit të rastit, dokumentacionit të ofruar dhe intervistave me fëmiun.

Për mbrojtjen e fëmijëve një vlerësim kërkon të identifikojë:

- Nevojat e plota të fëmijëve, në lidhje me moshën e tyre dhe me zhvillimin, duke i pasur parasysh dimensionet e mirëqenies;
- Rreziqet për fëmijët për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë;
- Cilësitë e mira dhe burimet e fëmijëve, të familjes dhe të komunitetit.

Vlerësimi nuk është i njëjtë si hetimi i cili mund të bëhet nga policia ashtu që i pandehuri të mund të ndiqet penalisht. Ky vlerësim kryesisht është i fokusuar në nevojat e fëmijëve (dhe të familjeve të tyre) dhe në sigurinë e tyre. Gjatë procesit të vlerësimit duhet përfshirë fëmijët dhe familjet. Të gjitha agjencive që punojnë me fëmijë apo që mund të kenë dijeni për familjen, duhet kërkuar të ofrojnë informata me qëllim që të shfrytëzohen në procesin e vlerësimit.

Të gjitha vlerësimet duhet t'i ndjekin fazat e njëjta: Planifikimi i vlerësimit; Mbledhja e informatave; Verifikimi i informatave; Analiza dhe plani i reagimit.

Menaxheri i rastit/QPS-ja realizon intervistën miqësore me fëmijën e pashoqëruar të riadhesuar dhe sipas nevojës në intervistë mund të përfshijë edhe ZKKK-në dhe Koordinatorin e Riintegritimit. Fëmijët intervistohen mundësisht në një ambient miqësor dhe sipas parimeve të intervistimit miqësor.

Vlerësimi i nevojave shqyrton në veçanti:

- (1) Gjendjen e ushqimit;
- (2) Gjendjen shëndetësore duke përfshirë shëndetin mendor;
- (3) Nivelin e shkollimit dhe vijueshmërinë në shkollë;
- (4) Gjendjen e banimit;
- (5) Gjendjen ekonomike të familjes;
- (6) Strukturën e familjes;
- (7) Disponueshmërinë e dokumentacionit, duke përfshirë dokumentet e gjendjes civile dhe ato shkollore;
- (8) Aftësitë e kufizuara dhe nivelin e kufizimit;
- (9) Njohuritë gjuhësore;
- (10) Aftësinë profesionale, mundësinë e punësimit dhe nevojën e mundshme për trajnim profesional;
- (11) Cenushmëritë specifike duke përfshirë rrezikun nga marginalizimi, dhunën në familje dhe fëmijët në rrezik nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi;
- (12) Ekzistencën e rrjetit mbështetës (të afërm apo miq);
- (13) Çfarëdo informate tjetër relevante.

Vlerësimi i nevojave nënshkruhet bashkërisht nga Menaxherini rastit/QPS-ja, ZKKK-ja, dhe Koordinatori Rajonal/DRPR. ZKKK-ja regjistron vlerësimin e nevojave në sistemin e menaxhimit të rastit brenda 24 orëve. Në rast se kërkohet veprim emergjent, Koordinatori Rajonal brenda 24 orëve informon DRRP-në, e cila ndërmerr veprime konkrete, duke u koordinuar sipas nevojës me akterët relevantë.

Kapitulli V. Ofrimi i shërbimeve emergjente për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar

Akterët kryesorë: Komunitat, Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar) Ministria e Shëndetësisë.

Pakot e ndihmës

Pakoja e ndihmës me ushqim dhe mjete të nevojshme higjienike sigurohet nga programi i riintegritit/DRPR menjëherë pas arritjes. Pakoja sigurohet konform nivelit të zhvillimit dhe rritjes për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar të cilët për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike familjare, kjo pako nuk mund të sigurohet nga familja.

Trajtimi mjekësor

Ndihma mjekësore sigurohet menjëherë pas arritjes nëse nevoja për këtë ndihmë i është komunikuar DRPR-së nga shteti dërgues para arritjes. Në rast nevojë kujdesi mjekësor sigurohet edhe pa informim paraprak nga mjekët e aeroportit. Fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha rethanat i sigurohet trajtim shëndetësor falas që ofrohet në institucionet shëndetësore publike.

Trajtimi psiko-social në rast nevojë

Fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar iu ofrohet trajtimi psiko-social në institucionet publike shëndetësore dhe në rast nevojë iu ofrohet mbulimi i shpenzimeve për medikamentet të cilat nuk gjenden në Listën Esenciale të Barërave (LEB).

Pako dimërore

Pakoja e ndihmës për dimër mund të sigurohet për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar familja e të cilëve për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe sociale, nuk mund t'i sigurojnë vetë lëndët djegëse. Pakoja për dimër shpërndahet vetëm një herë për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar të cilat kthehen gjatë sezonit të dimrit dhe mund të shfrytëzojnë këtë pako për ngrohje.

Kapitulli VI. Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për riintegrim të qëndrueshëm për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar

6.1. Banimi

Akterët kryesorë: Komunat, **Qendrat për Punë Sociale**, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar.

Fëmijët e riatdhesuar të pashoqëruar akomodohen në familjen e tyre për banim. Në rast nevojë ata mund të jenë përfitues të skemave për përmirësimin e kushteve të banimit siç parashihet me legjislacionin e riintegritimit në fuqi. Kërkesa për përfitim parashtrohet nga prindi i fëmijës së pashoqëruar të riatdhesuar.

Renovimi ose rindërtimi i shtëpive:

Fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar mund të përfitojnë renovim ose rindërtim të shtëpive të tyre nëse dëshmohet se shtëpia në të cilat ata kanë jetuar më herët, është plotësisht ose pjesërisht e shkatërruar. Dokumentet e nevojshme që dëshmojnë pronësinë e prindit, dokumentet e dëmtimeve ose shkatërrimeve të pronës, si dhe lejen e komunës për rindërtim edhe vërtetimin se prindi nuk është përfitues i ndonjë programi të mëhershëm për këtë qëllim, duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Shtëpia e renovuar apo rindërtuar duhet të shfrytëzohet për banim nga fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar dhe familjet e tyre.

Mobilimi/inventarizimi i shtëpive:

Pakoja e orendive mund të sigurohet për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar nëse atyre iu mungojnë orenditë dhe kanë nevojë për këtë pako. Përmbajtja e pakos së orendive është specifikuar në Rregulloren për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegritimit. Pakoja duhet të përmbush nevojat elementare për zhvillimin edukativ dhe shëndetësor të fëmijëve. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmbushjes së nevojave për fëmijët që kanë aftësi të kufizuara. Pakoja e orendive mund të sigurohet vetëm një herë.

6.2. Arsimi

Akterët kryesorë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Komunat (Drejtoria Komunale e Arsimit, Shkollat, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim), Ministria e Punëve të Brendshme/DRPR.

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i detyrueshëm dhe ofrohet falas për të gjithë. Arsimi i mesëm i lartë i përgjithshëm dhe profesional është i hapur dhe i mundshëm për të gjithë fëmijët dhe ndërmerren masa të përshtatshme duke ofruar

edhe bursa për shkollim sipas nevojës. Informacioni dhe orientimi në karrierë është i mundshëm dhe i arritshëm për çdo fëmijë.

Arsimi është segment i rëndësishëm i riintegrit të fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar. Ku fëmijët zhvillojnë aftësi për t'u bërë pjesëtarë aktiv të shoqërisë, si dhe favorizon përfshirjen sociale duke promovuar ndërveprimet shoqërore, duke bërë fëmijët të pranishëm dhe me qasje në shërbime publike, gjë që mundëson identifikimin e problemeve sipas nevojës. MASHT dhe DKA-të kanë përgjegjësinë primare në sigurimin që fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar të kenë qasje në arsim cilësor. Qasja në arsim cilësor për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, veçanërisht fëmijët e me aftësi të kufizuara, bie në përgjegjësitë e MASHT. MPB/DRRP përkrahë përmbushjen e të drejtës në arsim të fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duke ofruar përkrahje në identifikimin e fëmijëve, monitorim të progresit dhe koordinimit ndër-sektorial në nivelin qendror.

Të sigurohet që fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, të cilët mund të jenë në gjendje të vështirë, për shkak të mosnjohjes së gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe që nuk janë të familjarizuar me sistemin arsimor në Kosovë, regjistrohen në shkollë, marrin edukim cilësor, ndjekin mësimin. Në raste të caktuara kur fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar për shkak të qëndrimit jashtë vendit të origjinës, kanë humbur nga procesi mësimor, atyre duhet t'i sigurohet arsimi plotësues për të qenë i aftë me vazhdimin e shkollimit sipas moshës dhe aftësive të fëmijut. Fëmijëve më aftësi të kufizuara duhet t'i ofrohet arsim dhe aftësim profesional konform nevojave të tyre. MASHTI, DKA-ja dhe institucionet tjera arsimore duhet të kenë konsideratë se të gjitha këto kërkojnë masa specifike.

6.2.1. Sigurimi i qasjes në shkollë për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar

Regjistrimi

DKA-ja, punon me drejtorët e shkollave në lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve e pashoqëruar të riatdhesuar në shkolla, duke pasur parasysh fëmijët pa certifikatë të lindjes apo certifikatë shkollimi, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Kurset e gjuhës dhe mësimi plotësues

Identifikimin e nxënësve që kanë nevojë për kurse të gjuhës dhe mësim plotësues e bënë shkolla në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës të DKA-së për organizimin e kurseve të gjuhës dhe mësimi plotësues për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar. Drejtoritë Komunale për Arsim, në koordinim me MASHT, organizojnë kurse të gjuhës dhe mësimi plotësues për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar që nuk flasin gjuhën me të cilën mësohet në shkollë. DKA e informon MASHT lidhur me nevojat e tyre për kurse të gjuhës dhe mësim plotësues. MASHT në bashkëpunim me koordinatorin rajonal monitorojnë procesin e mbajtjes së kurseve dhe mësimi plotësues. MASHT-i siguron planprogramet, materialin pedagogjik, përzgjedhjen dhe trajnimin e mësimdhënësve.

Financimi

MPB-ja/DRRP alokon buxhetin relevant MASHT-it për kurset e gjuhës dhe mësimi plotësues për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar. MASHT-i monitoron mbarvajtjen e kurseve të gjuhës dhe mësimi plotësues dhe i raporton MPB-së/DRRP-së.

Transporti

Komunat sipas nevojës organizojnë transportin për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar në mënyrë që ata të ndjekin kurset e gjuhës dhe mësimin plotësues.

Programet e veçanta për regjistrimin dhe mbajtjen e fëmijëve në shkollë

MASHT cakton programe të veçanta për regjistrimin dhe mbajtjen e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar në shkollë. Këto programe fokusohen ndër të tjera në vizitë të drejtpërdrejtë në vend tek familjet dhe adresimin e shkaqeve rrënjësore për mospërfshirje apo braktisje nga shkolla. Programet e tilla kombinohen me programet ekzistuese për regjistrim dhe mosbraktisje. Në këtë mënyrë, ata punojnë bashkë me prindërit, familjet e afërta, familjet strehuese, organizatat e komunitetit dhe OJQ-të tjera relevante. Ata mund të delegojnë implementimin e programeve të tilla apo të bëjnë partneritet me OJQ-të. Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit (EPRBM), në bashkëpunim me ZKKK-në dhe koordinatorët për riintegrim, organizojnë konsulta me prindërit e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, së paku një herë në vit lidhur me statusin e procesit të riintegritimit në lidhje me arsimin. Rezultatet ndahen me MASHT-in dhe MPB-në/DRRP si pjesë e procesit të raportimit.

Identifikimi i fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, që mbesin jashtë sistemit arsimor

MASHT në bazë të legjislacionit në fuqi përcakton shkallën e shkollimit të fëmijëve të riatdhesuar dhe i sistemon ata në sistemin e arsimit. Si pjesë e vlerësimit të nevojave që kryhet me arritjen e fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar siç është përshkruar në këtë udhëzues, identifikohet numri i fëmijëve dhe niveli i tyre i shkollimit, gjuhën që flasin dhe sfidat specifike që duhen adresuar (transporti për në shkollë, gjendja socio-ekonomike e familjes, etj.).

Zyrtari përgjegjës i përfshin informatat në sistemin e menaxhimit të rasteve (SMR). Gjatë vizitave të rregullta, menaxheri i rastit dhe koordinatorët e riintegritimit verifikojnë regjistrimin në shkollë dhe ndjekjen e mësimave nga fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar. Nëse zbulon se fëmijët nuk janë në shkollë, ata informojnë DKA-të për veprime konkrete. Drejtorët e shkollave janë gjithashtu përgjegjës për identifikimin e nevojave specifike tek fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar dhe barrierave në ndjekjen e mësimit dhe këshillimin e Drejtoratit Komunal për Arsim. DKA i ndan këto informata me MASHT, ZKKK, DRPR. DKA-ja informon ZKKK-në në baza të rregullta dhe raporton sipas kërkesës tek MASHT-i lidhur me regjistrimin dhe ndjekjen e shkollimit nga fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar dhe raporton për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar që nuk janë në shkollë.

6.2.2. Ofrimi i arsimit cilësor

MASHT-i përkujdeset që aktivitetet e rregullta trajnuese dhe/ose trajnimet specifike të mësimdhënësve që punojnë në zonat me numër të konsiderueshëm të fëmijëve të rrezikuar nga mospërfshirja, në veçanti fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar dhe fëmijë nga grupe tjera të cënueshme, të përfshijnë module lidhur me përvojën e veçantë të atyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këta fëmijë dhe mënyrat për t'i trajtuar.

MASHT-i promovon zhvillimin e materialit pedagogjik për mësimdhënësit që përfshijnë module lidhur me përvojën e veçantë, sfidat me të cilat ballafaqohen fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, posaçërisht ata nga grupet e cënueshme, dhe mënyrat për t'i trajtuar ato. MASHT-i përkrah hulumtimin, analizën dhe promovimin e praktikave të mira për ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët e riatdhesuar përmes buletineve dhe botimeve të rregullta për mësimdhënësit, punëtorët social dhe profesionistët tjerë edukativo-arsimor.

6.3. Shëndeti

Akterët kryesorë: Ministria e Shëndetësisë, Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, QKMF, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), Ministria e Punëve të Brendshme(MPB/DRPR).

Qasja në shëndetësi - Informimi

Fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar informohen lidhur me shërbimet shëndetësore në Kosovë dhe mënyrën e qasjes në të. MSH përkujdeset për sigurimin e fletëpalosjeve informuese. Informatat që ofrohen për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar duhet të jenë të shkruara në gjuhën miqësore. Fletëpalosjet do të jenë në dispozicion në Zyrën Pritëse në ANP, në ZKKK dhe në Qendrat Sociale.

7.3.1 Shëndeti mendor

Qendrat e Shëndetit Mendor përmes ekipeve profesionale multidiciplinare do të përcjellin gjendjen e shëndetit mendor të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar në familjet tyre. Raportimi i gjendjes së tyre shëndetësore do të bëhet në DRPR përmes koordinatorëve të riintegrit. Trajtimi psiko-social i fëmijëve në nevojë do të jetë në qendër të vëmendjes nga QSHM-të. DRPR, në bashkëpunim me MSH, MASHT-in dhe MPMS-në, përkrahin zhvillimin e programeve trajnuese për profesionistët shëndetësorë që merren me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar.

Profesionistët, e në veçanti psikologët, të gjithë fokusin e përkrahjes duhet ta drejtojnë në kuptim të promovimit dhe fuqizimit të besimit, konfidencës dhe sigurisë për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, me qëllim të krijimit të një bazë të qëndrueshme të reintegrit të tyre.

Profesionistët që ofrojnë këto shërbime duhet të trajnohen veçanërisht në:

- Komunikimin miqësor dhe konform moshës së fëmijëve;
- Zhvillimin e ndjenjës për të qenë një ndëgjues i mirë;
- Motivimin e fëmijëve për të vazhduar me mësimet dhe për të vijuar ndonjë nga kurset e mundshme të aftësisimit profesional;
- Aftësitë për të identifikuar ndonjë shenjë të paaftësisë apo dhunës, abuzimit, shfrytëzimit të fëmijës.

Sistemi i menaxhimit të rasteve shëndetësore

Informatat lidhur me shëndetin mendor të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar do të jenë pjesë e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), dhe janë të qasshme vetëm nga profesionistët shëndetësorë në kushte konfidencialiteti. QSHM përmes koordinatorëve për riintegrim raporton në baza të rregullat në DRPR për nevoja shëndetësore psiko-sociale të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar.

6.4. Regjistrimi Civil

Akterët kryesorë: MPB-ja/Angjencia e Regjistrimit Civil, Komunitat(Zyrat e Gjendjes Civile), DRPR-ja, DSHAM-i dhe ZKKK-ja.

Regjistrimi i fëmijëve të pashoqëruar

Me të arritur në PKKK, zyrtari i pritjes që pranon fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar kontrollon posedimin e dokumenteve të gjendjes civile për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, në veçanti posedimin e certifikatave të lindjes për fëmijët e lindur jashtë Kosovës, sipas këtij udhëzuesi. Ai përfshinë informatat në sistemin e menaxhimit të rastit. Fëmijët e pashoqëruar të lindur jashtë Kosovës, të cilët nuk i posedojnë certifikatat e lindjes me rastin e kthimit, nuk mund të ripranohen në Kosovë.

Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar

Zyrat e gjendjes civile në komunën përkatëse i regjistrojnë fëmijët e riatdhesuar të pa shoqëruar, të cilët nuk janë të regjistruar në gjendjen civile, duke i vlerësuar dokumentet në dispozicion dhe në harmoni me legjislacionin përkatës në fuqi. Qendrat për pajisje me dokumente në nivelin komunal bëjnë të gjitha përpjekjet për të lehtësuar pajisjen e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar me dokumente personale, në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Shtrirja e shërbimeve deri te familjet

Ekipi monitorues verifikon nëse fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, posaçërisht fëmijët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptian, janë të regjistruar në gjendjen civile. Në rast identifikimi të fëmijëve të paregjistruar, ekipi monitorues referon dhe monitoron regjistrimin civil të këtyre fëmijëve. Ekipi monitorues informon familjet lidhur me hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar dokumentacion civil për të gjithë anëtarët e familjes, posaçërisht certifikatat e lindjes për fëmijët. Ekipi monitorues informon familjet përkatëse lidhur me ngjarjet e veçanta që mbahen në komunë për regjistrim civil. Fletëpalosje informative për mënyrën e regjistrimit të fëmijëve dhe përfitimet nga regjistrimi i lindjes shpërndahen në këto familje.

6.5. Mirëqenia sociale

Akterët kryesorë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare, Komunitat/ Qendrat për Punë Sociale (QPS), Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), DRPR.

6.5.1. Asistenca sociale dhe qasja në beneficione

Fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar kanë qasje në beneficionet dhe asistencën sociale që është në dispozicion për të gjithë qytetarët e RKS-së. DRPR përfshinë në fletëpalosjet informative për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, informatat lidhur me beneficione të qëndrueshme në dispozicion, kushtet dhe mënyrat për të aplikuar për to. ZKKK-ja informon fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar lidhur me procesin e aplikimit për beneficione dhe asistencë sociale, si dhe përkrah të riatdhesuarit sipas nevojës, në plotësimin e formularëve dhe dorëzimin e tyre tek shërbimet relevante sociale. ZKKK-ja regjistron informatat në SMR.

Sigurimi i mirëqenies sociale përkrah riintegrimin e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar në nevojë. Programet më të rëndësishme të mirëqenies sociale janë: skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe skema e ndihmës sociale, strehimi familjar tek të afërmit, strehimi familjar në familjet strehuese dhe strehimi residencial. Të gjitha skemat menaxhohen nga MPMS e cila duhet të sigurojë përfshirjen e të gjithë fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, që gëzojnë këtë të drejtë, në skemat e lartcekura.

Punësimi i fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar

Në pajtueshmëri me Ligjin e Punës, fëmijet e pashoqëruar të riatdhesuar në konsultim me menaxherin e rastit, prindin dhe gadishmërinë e tij, mund të themeloj marrëdhënie të lehta pune që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor.

Kapitulli VII. Mbrojtja e Fëmijëve të Pashoqëruar

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi

Mbrojtja e fëmijës - nënkupton aktivitetet që ndërmerren për të mbrojtur fëmijët që janë duke vuajtur, ose ka të ngjarë të vuajnë nga një rrezik serioz, si dhe çdo veprim që siguron fëmijën të jetojë në një familje apo mjedis tjetër të sigurt, ku mbrohet jeta dhe shëndeti dhe respektohen të drejtat e tij, ku sigurohet edukimi, arsimi dhe zhvillimi, duke i mbrojtur ata nga çfarëdo lloj dhune, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, keqtrajtimi, eksploatimi, lënia pas dore, abuzimi dhe shfrytëzimi, në çdo kontekst, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikatat e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjinitale, martesat e fëmijëve dhe abuzimi (Protokolli i punës, 2015).

Mbrojtja nënkupton veprimet gjithëpërfshirëse për të ndihmuar fëmijët e pashoqëruar:

- Veprime reaguese: Qëllimi i të cilave është parandalimi apo ndalimi i formave të abuzimit dhe dhunës, si dhe në ato raste kur kanë ndodhur këto të fundit eliminimin e efekteve që mund të sjellin ato.
- Veprimet kthyes: që kanë për qëllim ritkimin e kushteve të dinjitetshme të jetës nëpërmjet rehabilitimit, restitimit dhe riparimit.
- Krjimi i hapësirave të reja: me qëllim krijimin apo konsolidimin e ambientit mundësues (politik, institucional, ligjor, social, kulturor dhe ekonomik) që respekton të drejtat e të gjithë fëmijëve pa dallim.

Menaxheri i rastit në bashkëpunim me Kordinatorin e Riintegrit viziton rregullisht (së paku 1 herë në muaj) fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar. Zyrtari përgjegjës i DRPR-së regjistron gjendjen në SMR, përmes së cilës monitorohet mbarvajtja e riintegrit të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar. Në rast kur fëmijët rrezikohen të mbesin pa shtëpi, në varfëri të skajshme, të neglizhuar, në rrezik të të qenit të neglizhuar, apo viktimat të dhunës e abuzimit, merren masa urgjente nga menaxheri i rastit së bashku me akterët relevant. Tryeza për menaxhimin e rasteve (TMR) për fëmijët në rrezik nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi brenda QPS-së ekzaminon rastin dhe vendos lidhur me veprimet pasuese. Në këtë rast zyrtari komunal nga ZKKK-ja dhe kordinatori i riintegrit merr pjesë në Tryezën për Menaxhimin e Rasteve (TMR-në). QPS-ja ndërmerr veprimet e domosdoshme sipas mandatit të saj. Mund të bëjë rekomandime specifike për qasje në beneficione për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duke përfshirë “asistencën e rastit” të paraparë në Rregulloren për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrit.

MPB-ja/DRRP përkrahë personelin e QPS-së për adresimin e sfidave specifike me të cilat ballafaqohen fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, në veçanti fëmijët nga grupet e cënueshme. DRPR dhe komuna, mund të lidhin partneritet me OJQ-të relevante për ofrimin e përkrahjes adekuate për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar përmes procedurës së thirrjes së hapur për projekt propozime.

Kapitulli VIII. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve

Akterët kryesorë: Ministria e Punëve të Brendshme (Departamenti për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar), (Departamenti i Teknologjisë Informative), Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve është sistem elektronik i cili administrohet nga MPB/DRPR në të cilin regjistrohen, ruhen, procedohen dhe arkivohen kërkesat dhe të dhënat tjera relevante lidhur me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar dhe përfitimet e tyre. Të dhënat e fëmijëve të riatdhesuar duke përfshirë ndihmën dhe mbështetjen gjatë riintegritetit regjistrohet në SMR. Përmes SMR-së menaxhohet në tërësi procesi i riintegritetit të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar nga momenti i hyrjes në Kosovë deri në mbylljen e rastit, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Të dhënat e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar trajtohen në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Akterët e përfshirë në çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar mbajnë shënime për aktivitetet e kryera duke përfshirë vizitat e realizuara. Drejtoratet komunale i komunikojnë informatat ZKKK-së e cila i regjistron këto të dhëna në SMR. MPB-ja organizon dhe ofron trajnime për përdorimin e SMR-së për të gjithë akterët që merren me regjistrimin e të dhënave. Koordinatorët rajonal të DRPR-së përfitojnë trajnime shtesë dhe i përkrahin komunat në përdorimin e SMR-së.

Nga SMR-ja deri në veprimet e integruara

SMR-ja mundëson evidentimin e çështjeve që kërkojnë vëmendje dhe veprime konkrete. Mundëson monitorimin e adresimit të nevojave, veprimeve të ndërmarrura dhe rezultatet e atyre veprimeve. DRPR-ja mbikëqyrë në vazhdimësi veprimet e ndërmarrura për ndihmë dhe mbështetje të fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar që kërkojnë vëmendje specifike. Në kuadër të DRPR-së emërohet zyrtari përgjegjës për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar.

Menaxhimi i të dhënave dhe analizat

Analiza e të dhënave nga SMR-ja përdoret për planifikimin e politikave të riintegritetit. Në veçanti, planifikimi për nevojat financiare bazohet kryesisht në të dhënat e viteve paraprake të raportuara në SMR. DRPR-ja është përgjegjëse për analizimin e të dhënave së paku një herë në vit. Në këtë rast merret në konsideratë bashkëpunimi me Agjencinë e Statistikave, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të relevante.

Kapitulli IX. Koordinimi ndërmjet akterëve në nivelin qendror dhe lokal

DRPR si organ përgjegjës për vlerësimin e zbatimit të politikave të riintegritit mban takime të rregullta ku diskutohen progresi, sfidat dhe mënyrat e adresimit të tyre. Në këto takime marrin pjesë akterët relevant përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të relevante. Në këto takime mund të ftohen edhe donatorët dhe përfaqësues të vendeve kthyes.

9.1. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin qendror

DRPR është përgjegjëse për koordinimin e riintegritit të fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar. Zyrtaret përgjegjës të ministrive relevante koordinojnë aktivitetet e riintegritit të fëmijëve të pa shoqëruar në bashkëpunim të ngushtë me DRPR.

9.2. Koordinimi ndër-sektorial në nivelin lokal

Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim është përgjegjëse për koordinimin e riintegritit të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar në nivel lokal. Ajo është pika kryesore kontaktuese me personat e riatdhesuar. Ajo i referon rastet tek drejtoritë përkatëse për veprim dhe monitoron e përcjell veprimet e ndërmarra. Në pajtueshmëri me Rregulloren 02/2010 për Zyrat Komonale për Komunitete dhe Kthim, të gjithë zyrtarët e komunës janë të obliguar të bashkëpunojnë me ZKKK-në gjatë kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së përgjegjësisë të saj me qëllim të lehtësimit të riintegritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar.

Përveç shqyrtimit të kërkesave individuale, ZKKK në bashkëpunim me Komisionin Komunal për Riintegrim mbajnë takime të rregullta çdo tre muaj në mënyrë që të vlerësojë progresin në riintegrim të personave të riatdhesuar në komunë, të vlerësojë rezultatet e arritura, të shqyrtojë sfidat që duhen adresuar dhe të identifikojë boshllëqet dhe masat për përmirsim. ZKKK-ja i kryeson këto takime.

Në mënyrë specifike ZKKK dhe Komisioni Komunal për Riintegrim:

- (1) Rishikon statusin e riintegritit të personave të riatdhesuar, posaçërisht fëmijëve dhe grupeve të cënueshme, brenda komunës;
- (2) Analizon të dhënat nga SMR-ja dhe diskuton për çështjet kryesore;
- (3) Rishikon progresin e riintegritit në sektorët kyçe (banimi, shëndeti, arsimi, regjistrimi civil, punësimi dhe mirëqenia sociale);
- (4) Vlerëson nevojat specifike për përkrahje nga niveli qendror.

Pas çdo takimi të veçantë, KKR-ja nxjerr raport progresi në lidhje me implementimin e procesit të riintegritit, thekson sfidat dhe nxjerr rekomandime për avancimin e riintegritit afatgjatë të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar. Raporti, bashkë me rekomandimet, i dorëzohet DRPR-së përmes Koordinatorit Rajonal.

ZKKK-ja i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal raporte vjetore lidhur me aktivitetet e riintegritit të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar dhe nevojat për planifikim. Kuvendi Komunal organizon takim të veçantë çdo vit në dhjetor për të diskutuar raportin dhe progresin e arritur në riintegrimin e fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, në veçanti personave të cënueshëm. Takimi është publik sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. OJQ-të relevante, organizatat ndërkombëtare që punojnë për dhe me personat e riatdhesuar dhe përfaqësuesit e personave ftohen për të marrë pjesë përmes thirrjes publike.

9.3. Koordinimi vertikal

Komunat kanë përgjegjësinë kryesore për riintegrim afatgjatë të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, siç parashihet në Rregulloren për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrit. Për të siguruar që komunat kanë mjete për të përmbushur rolin e tyre, MPB-ja dhe ministritë tjera relevante u ofrojnë komunave përkrahjen adekuate teknike, financiare dhe koordinuese. Koordinimi i procesit të riintegrit të fëmijëve të pashoqëruar ndërmjet DRPR dhe nivelit lokal bëhet përmes koordinatorëve të riintegrit të MPB-së të cilët identifikojnë nevojat dhe lehtësojnë bashkëpunimin ndërmjet komunave.

Përkrahje e përgjithshme e ofruar nga MPB/DRPR-ja për komunat përfshinë:

- (1) Sigurimin e udhëzuesve lidhur me obligimet e komunave sipas Rregullores për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrit dhe Strategjisë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar brenda tre muajsh pas aprovimit të standardeve të reja, akteve ligjore dhe dokumenteve tjera të politikave;
 - (2) Sigurimin e formularëve model për dorëzimin e kërkesave për përfitim në secilin sektor brenda tre muajsh pas aprovimit të standardeve të reja, akteve ligjore dhe dokumenteve tjera të politikave;
 - (3) Sigurimin e dokumenteve model për zhvillimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit me organizatat partnere brenda tre muajsh pas aprovimit të standardeve të reja, akteve ligjore dhe dokumenteve tjera të politikave;
- Ofrimi i fletëpalosjeve informative, broshurave dhe materialit tjetër informues për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar;
- Sigurimi i formave standarde për dorëzim të raportit të progresit dhe raporteve vjetore nga ZKKK-ja;

Përkrahja specifike e ofruar nga ministritë relevante për komunat përfshijnë:

- (1) Asistencë teknike për zbatimin e politikave në fushat përkatëse;
- (2) Ministritë e përfshira përkrahin komunat në identifikimin e partnerëve adekuat për zbatimin e politikave përkatëse që ndërlidhen me riintegrim të qëndrueshëm;

Komunat ndërmarrin veprime për të kërkuar përkrahjen e nevojshme nga niveli qendror. MAPL e ndihmon dhe mbështet MPB/DRPR-në hartimin e planeve të trajnimit dhe organizimin e tyre për ngritjen e kapaciteteve nivelin lokal. Komunat në baza të rregullta periodike i dërgojnë MPB/DRPR raporte me të dhënat për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar në komunën përkatëse. MPB/DRPR përmbledhë raportet dhe i ndanë ato me akterët relevant.

Kapitulli X. Menaxhimi i Buxhetit të Riintegrit

Akter kryesor: Ministria e Punëve të Brendshme/DRPR, Ministria e Financave/MF, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/MMPH.

Buxheti i Riintegrit alokohet çdo vit si pjesë e buxhetit të MPB-së. Shpenzimi i tij bëhet në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Prokurimin Publik, Rregulloret mbi Thesarin 01 dhe 02 dhe Urdhëresat Administrative dhe aktet tjera normative të lëshuara nga Ministria e Financave.

Kapitulli XI: Monitorimi dhe llogaridhënia

11.1. Monitorimi i progresit

DRPR është organi përgjegjës për monitorimin e riintegrit të qëndrueshëm të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar. Monitorimi i progresit realizohet përmes vizitave në teren, të dhënave në SMR dhe raporteve të rregullta e informatave të pranuar nga akterët relevant. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa asnjë dallim, siç është raca, përkatësia etnike, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose diçka tjetër. Departamenti i Mirëqenies Sociale bashkëpunon me DRPR-në, komunat, rrethet akademike dhe me akterët e tjerë që janë të përfshirë me çështjen e shërbimeve sociale dhe familjare.

Përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Rasteve

Sistemi për Menaxhimin e Rasteve (SMR) është sistem elektronik në të cilin regjistrohen dhe arkivohen të gjitha kërkesat, ndihma dhe mbështetja e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar. Përmes këtij sistemi menaxhohet dhe monitorohet në tërësi procesi i riintegrit për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar nga momenti i ripranimit në Kosovë deri në riintegritin e qëndrueshëm të tyre.

Dorëzimi i raporteve dhe transparenca

MPB/DRPR në fund të çdo viti nxjerr raport vjetor të progresit lidhur me riintegritin e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar dhe shfrytëzimin e fondeve nga programi i riintegritit i cili publikohet në ueb faqen e MPB. Raporti pasqyron aktivitetet e të gjithë akterëve relevantë, të cilët ndihmojnë dhe e mbështesin riintegritin e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar. Raporte periodike ndahen edhe me Komisionin Evropian dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare.

Mbrojtja e Përgjithshme e të Dhënave

Informatat ruhen apo transmetohen verbalisht, në letër apo në mënyrë elektronike të cilat trajtohen në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. I gjithë stafi i përfshirë në punë duhet të jetë i njohur me protokollet për mbrojtjen e të dhënave dhe implikimet për sigurinë nga të dhënat e ndjeshme. Qasja në informata të fëmijëve duhet t'u kufizohet vetëm atyre që kanë nevojë ta dinë atë. Informatat duhen t'i përcillen vetëm një personi të caktuar për t'i pranuar ato, për qëllime të përcaktuara qartë. Dosjet duhen të mbahen në një vend të sigurt dhe të jenë të qasshme vetëm për ata që janë përgjegjës për informata. Askujt tjetër nuk duhet ofruar qasje e pavarur pa leje.

Përdorimi i të dhënave me qëllim të zhvillimit të politikave

ZKKK-ja analizon të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i nevojave në sistemin e menaxhimit të rastit dhe i shfrytëzon ato për përcaktimin e masave prioritare të politikave dhe për të raportuar lidhur me progresin. Koordinatori Rajonal i MPB-së ka gjithashtu qasje në të dhëna, në mënyrë që të përkrahë ZKKK-në në planifikimin e masave dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të përbashkëta sipas nevojës. Informatat dhe të dhënat në lidhje me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duhet të ruhen në mënyrë konfidenciale, dhe të përdoren vetëm për qëllime zyrtare të MPB-së apo të ndonjë institucioni tjetër relevant që kanë për qëllim avansimin e trajtimit apo mbrojtjes së kësaj kategorie të fëmijëve.

11.2. Llogaridhënia

11.2.1. Mjetet juridike për realizimin e të drejtave për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar

Të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar realizohen sipas legjislacionit në fuqi. Në rast të mohimit apo shkeljes së të drejtave të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar ndërmerren veprime ligjore për adresimin e këtyre shkeljeve sipas legjislacionit në fuqi. Për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar gjatë gjithë kohës duhet ofruar ndihmë juridike falas për të realizuar të drejtën e garantuar për të ankuar ndaj çdo vendimi apo procedure ligjore.

Ombudspersoni

Ombudspersoni mund të rishikojë ankesat e dorëzuara në lidhje me rastet e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar dhe të ndërmjetësojë me autoritetet publike në gjetjen e zgjidhjes. Në harmoni me mandatin e Ombudspersonit, me qëllim të lehtësimit të zgjidhjeve për raste specifike, Ombudspersoni mund të kërkoj qasje në dokumentet e shtetit kthyes në suaza të bashkëpunimit me Ombudspersonin e atij shteti. Fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar duhet të jenë të informuar përmes fletëpalosjeve informative lidhur me mjetet juridike që janë në dispozicion dhe mënyrën e qasjes në to. MPB/DRPR merr në konsideratë rekomandimet e Ombudspersonit, që ndërlidhen me qështjet e riintegritimit të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar.

Kapitulli XII: Promovimi dhe ngritja e kapaciteteve

Përgatitja e materialeve informuese

MPB/DRPR në bashkëpunim me akterët tjerë relevant përgatit fletëpalosjet informative në verzione miqësore për të drejtat dhe obligimet e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar me të gjitha informatat për ndihmën dhe përfitimet që i takojnë sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit përkatës në fuqi, me theks në të drejtat e fëmijëve, shkollim, edukim duke përfshirë mjetet juridike ekzistuese kundër shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. Shtojcë e fletëpalosjeve do të jenë të gjitha kontaktet e institucioneve relevante për ndihmë dhe mbështetje. Fletëpalosjet janë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe, rome, turke dhe angleze, të cilat iu shpërndahen fëmijëve të pashoqëruar në momentin e arritjes.

Trajnimi i zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar

DRPR siguron trajnime të zyrtarëve përgjegjës për riatdhesim dhe riintegrim e fëmijëve të pashoqëruar. Secili zyrtar pas pranimit të detyrës duhet të trajnohet në lidhje me:

- (1) Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet tjera ndërkombëtare në përgjithësi që rregullojnë këtë fushë, dhe në veçanti parimet kryesore të listuar në fillim të këtij udhëzuesi;
- (2) Legjislacionin në fuqi, duke përfshirë të drejtat dhe proceset për ripranimin dhe riintegrimin e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar;
- (3) Përvojën e fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar prej largimit të tyre nga vendi dërgues deri në integrimin e tyre;
- (4) Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar të cilët paraqesin rrezik të përjashtimit, dhe mundësitë në dispozicion për adresimin e nevojave të tyre;

- (5) Aftësitë për komunikim efikas me fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar, duke pasur parasysh që ata mund të jenë të shqetësuar me të arritur në vend. Një fokus të veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit për komunikim dhe intervistim miqësor;
- (6) Aftësitë për vlerësimin fillestar të nevojave të fëmijëve të pashoqëruar të riatdhesuar, duke përfshirë identifikimin e specifikave të cenushmërisë;
- (7) Aftësitë për adresimin e situatave emergjente, duke përfshirë emergjencat shëndetësore;
- (8) Menaxhimin e rasteve;
- (9) Mjetet juridike ekzistuese për fëmijët e pashoqëruar të riatdhesuar të drejtat e të cilëve nuk janë realizuar.

Secili zyrtar i angazhuar në riatdhesim dhe riintegrim do të trajnohet në vazhdimësi për ndryshimin e procedurave dhe/ose legjislacionit lidhur me:

- (1) Zhvillimin e proceseve;
- (2) Ndryshimin e trendeve për riatdhesim nga vendet dërguese;
- (3) Pasurimi i sistemit të menaxhimit të rasteve me module të reja dhe;
- (4) Trendet e bashkëpunimit dhe koordinimit gjatë procesit të ripranimit dhe riintegrit.